



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

**PËR NJOFTIMIN, KORRIGJIMIN APO NDALIMIN E INFORMACIONIT
PROMOCIONAL**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 154, datë 23.12.2014

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për njoftimin, korrigjimin apo ndalimin e informacionit promociional.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 68, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet nga shoqëritë e sigurimit për çdo informacion promociional, rreth saj dhe produkteve të ofruara në treg.

Neni 4
Njoftimi i informacionit promociional

4.1 Shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë në Autoritet çdo informacion promociional rreth saj dhe produkteve të ofruara në treg, jo më vonë se 15 ditë para publikimit të informacionit promociional, si dhe çdo ndryshim që shoqëria mund t'i bëjë këtij informacioni.

4.2 Shoqëria e sigurimit bashkë me njoftimin depoziton edhe çdo material (të shkruar apo elektronik) të përdorur për publikimin e informacionit promociional.

Neni 5
Procedura e Autoritetit

5.1 Autoriteti, shqyrton dhe vlerëson informacionin promociional. Në përfundim të shqyrtimit, Autoriteti, nëse konstaton se nuk janë respektuar parashikimet e nenit 68, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me shkresë zyrtare i kërkon shoqërisë së sigurimit korrigjimin ose ndalimin e tij.

5.2 Vlerësimi i Autoritetit nuk mund të përdoret për qëllime promociionale.

5.3 Gjatë periudhës së shqyrtimit, shoqëria e sigurimit nuk mund të procedojë me publikimin e informacionit promociional.

Neni 6

Kërkesa për korrigjimin e informacionit promociional

6.1 Pas shqyrtimit të informacionit promociional, Autoriteti mund të kërkojë korrigjimin e tij duke u shprehur për ndryshime apo për përfshirjen e informacioneve shtesë.

6.2 Autoriteti kthen për korrigjim informacionin promociional, nëse vlerëson se:

- a) ky informacion nuk është në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 68 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- b) është e nevojshme në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit.

Neni 7

Ndalimi i informacionit promociional

7.1 Autoriteti ndalon publikimin e informacionit promociional nëse konstaton se shoqëria e sigurimit nuk ka vepruar në përputhje me kërkesën për korrigjim të parashikuar në nenin 6, të kësaj rregulloreje.

7.2 Autoriteti ndalon publikimin e informacionit promociional në çdo rast që e gjykon si të papërshtatshëm dhe në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 68 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 8

Sanksione

Shkelja e detyrimit të përcaktuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, është objekt i sanksioneve të parashikuara në nenin 256, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 9

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI